



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.376/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me apelin e Organizatës GERMIN, me seli në Prishtinë, të paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të mos procedimit të 4.639 fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës si fletëvotime të rregullta dhe mos numërimit të të njëjtave në Q.N.R, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 19.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejueshëm apeli i evidentuar si Anr.376/2019 i datës 18.10.2019, i paraqitur nga Organizata GERMIN, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që 4.639 fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës, të pranuar në KQZ prej datës 08.10.2019 deri më datë 11.10.2019, të procedohen si fletëvotime të rregullta dhe të lejohet numërimi i të njëjtave në Q.N.R.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2019, Organizata GERMIN, me seli në Prishtinë, ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.376/2019, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilën theksohet se Organizata GERMIN, gjatë monitorimit të procesit të pranimit dhe verifikimit të pakove të votave të dërguara përmes postës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, ka vërejtur se KQZ-ja, i ka kualifikuar si të papranueshme 4.639 pako me fletëvotime që kanë ardhur përmes postës në adresë të KQZ-së, pas datës 5 tetor 2019, por para fillimit të numërimit të votave tjera me postë, ashtu që këto pako të fletëvotimeve, të ardhura nga bashkëqytetarët që jetojnë jashtë vendit janë refuzuar apriori, pa kaluar asnjë procedurë verifikimi. Sipas paraqitësit të apelit, të gjitha këto pako janë nisur si dërgesa postare para-afatit përfundimtar për dërgimin e pakove postare të vendosur nga KQZ-ja, përkatësisht nga data 19 shtator deri më datë 5 tetor 2019, gjë kjo e cila sipas të njëjtit mund të vërtetohet në bazë të vulës postare në datën e nisjes, duke konsideruar se refuzimi i KQZ-së në mbledhjet e datës 12, përkatësisht 17 tetor 2019, për të trajtuar këto pako me fletëvotime të ardhura përmes postës, duke u bazuar në kufizimin kohor të pranimit të votave me postë, të vendosur nga KQZ, përbën shkelje të të drejtave zgjedhore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Më tej paraqitësi i apelit, në apel ka bërë një përshkrim të dispozitave ligjore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (respektivisht dispozitat e nenit 45 par. 1,2 dhe 3; nenit 22, nenit 53, 55), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme

(përkatësisht dispozitat e nenit 1, 2, 5, 96, 119), Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013 për Votimin jashtë Kosovës (neni 4, dhe neni 5), si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe GJEDNJ-së, dispozita këto të cilat kanë të bëjnë me të drejtat zgjedhore të qytetarëve. Sipas paraqitësit të apelit, kufizimi i afatit kohor për pranimin e votave jashtë Kosovës, në 24 orë para ditës së zgjedhjeve, nuk ishte e domosdoshme që të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, rrjedhimisht në bazë të nenit 55 par.2, të Kushtetutës, masa apo kufizimi i vendosur nuk është në proporcion me qëllimin, duke theksuar se kufizimi ligjor, në mënyrë që të jetë i lejueshëm duhet të ketë qëllim legjitim dhe duhet të jetë masë proporcionale për të arritur atë qëllim ashtu siç përcaktohet edhe nga Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin Nr.K0131/12, andaj, duke qenë jo e domosdoshme për arritjen e qëllimit, kjo masë paraqet shkelje të të drejtave zgjedhore të përcaktuara me nenin 45, lidhur me nenin 55 të Kushtetutës. Mospranimi i votave të qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit, por të cilat kanë arritur jashtë afatit të vendosur nga KQZ-ja, përveç që përbën cënim të të drejtave zgjedhore të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës, shkel edhe parimin e barazisë së votës, sipas të cilit e drejta e votës nuk nënkupton vetëm të drejtën për të votuar por edhe të drejtën e efektit të barabartë të votës me votat e qytetarëve të tjerë të Republikës. Vonesa në arritjen e pakove, para datës së zgjedhjeve, nuk është përgjegjësi e votuesve jashtë vendit, por pasojë e faktorëve objektiv, të pavarur nga votuesit dhe diaspora. Arsyet e vonesës së këtyre pakove, kanë të bëjnë me probleme të paralajmëruara teknike gjatë dërgesave postare. duke konsideruar se në këtë drejtim ka ndikuar edhe falimentimi i kompanisë ajrore "Adria Airways", gjatë kësaj kohe, e cila në shumë raste bën transportin e dërgesave postare, sidomos prej shteteve evropiane. Në fund ka shtuar se refuzimi i KQZ-së, për të numëruar votat e ardhura pas afatit të caktuar edhe pse votuesit nuk kishin përgjegjësi për vonesën e bën edhe më të rëndë "natyrën dhe vëllimin e kufizimit", në rastin konkret, ashtu që duke mos e marrë parasysh këtë fakt përpara se të refuzonin numërimin e 4.639 pakove në fjalë, KQZ-ja ka dështuar të përmbushë obligimet e saj kushtetuese sipas nenit 55 par.4, pasi që mos numërimi i votave të ardhura pas afatit, paraqet shkelje të nenit 3 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së, duke përfunduar se mungesa e vendimmarrjes nga ana e KQZ-së lidhur me këtë çështje të ngritur vazhdimisht nga GERMIN, rezulton në mohim të të drejtave zgjedhore të votuesve jashtë vendit dhe duke kërkuar nga PZAP-i, që në bazë të mandatit që i'a jep LQP-ja, respektivisht neni 115.1, të ndërmarrë veprime konkrete dhe hapa të nevojshëm ligjor për trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 19.10.2019, lidhur me pretendimet e paraqitësit të apelit, se KQZ-ja ka shkelur të drejtën e votës ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit, theksohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen nr.50/2019 të datës 12.10.2019, nga Departamenti për Operacione Zgjedhore-Divizioni i Shërbimit Votues (DVSH), ka pranuar raportin informues lidhur me pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës. Sipas KQZ-së, ky raport ka qenë vetëm raport informues për KQZ-në, e cila në këtë mbledhje nuk ka marrë vendim lidhur me dërgesat postare të arritura pas afatit të Periudhës së Votimit përmes postës (5 tetor 2019) në adresën postare të KQZ-së nga data 8 deri më 11 tetor 2019, të 4.639 dërgesave postare jashtë Kosovës, por ka kërkuar nga Departamenti i Operacioneve Zgjedhore-Divizioni i Shërbimit Votues (DVSH), që për rastin në fjalë, të zbatoj Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullat e KQZ-së.

PZAP, në kuptim të nenit 3 par.8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ankesën në fjalë vendosi ta trajtojë si apelim, duke konsideruar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës, konstatoi se pretendimet ankimore për mos numërimin e 4.639 pakove me fletëvotime të ardhura me postë nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë Kosovës, nuk mund të jenë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja ende nuk ka marrë vendim lidhur me numërimin e këtyre fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës, ashtu siç del edhe nga vet përgjigja në apel e KQZ-së, e paraqitur më datë 19.10.2019. Sipas përgjigjes së KQZ-së, raporti i prezentuar nga Departamenti i Operacioneve Zgjedhore-Divizioni i Shërbimit Votues, lidhur me pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, ka qenë raport informues në mbledhjen e KQZ-së, nr.50/2019 të datës 12.10.2019, dhe në këtë mbledhje nuk është marrë vendim nga KQZ-ja, por është kërkuar nga Departamenti i Operacioneve Zgjedhore-Divizioni i Shërbimit Votues, që në lidhje me rastin në fjalë, të zbatoj dispozitat ligjore të LZP-së dhe Rregullave të KQZ-së.

Meqenëse në rastin konkret nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, Paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit, të vendosë lidhur me numërimin e fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërshtuar ligjore. Në këtë rast, meqenëse nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendim lidhur me numërimin apo refuzimin për rinumërim të 4.639 pakove me fletëvotime të ardhura nga votuesit jashtë vendit, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, Paneli vendosi që në këtë fazë të procedurës ankesa të hudhet poshtë si e palejuar.

Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, të paraqes sërish ankesë, nëse konsideron se i është cënuar e drejta e pretenduar, edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Nga sa u tha më sipër, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 122 par.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.376/2019 më datë 19.10.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.